dukagjini
shtëpia botuese publishing house



3

# SHKATHTËSI PËR JETË

Për klasën e tretë të arsimit fillor

## LIBRI I MËSUESIT/ES

Visare Xhafa-Lajçi, Arbnor Pajaziti, Vjollca Komoni, Enver Hamiti

# SHKATHTËSI PËR JETË

Për klasën e tretë të arsimit fillor

## LIBRI I MËSUESIT/ES

**Visare Xhafa-Lajçi, Arbnor Pajaziti, Vjollca Komoni, Enver Hamiti**

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

**PRISHTINË, 2021**

**Parathënie**

Të nderuar mësuese/s,

Në zbatim të politikave të botimit të teksteve shkollore, me qëllim që çdo libër për nxënësin të shoqërohet me librin e mësuesit, ju vëmë në dispozicion librin e mësuesit për tekstin "Shkathtësi për jetë 3", të përpiluar në bazë të planprogramit të kurrikulës, në kuadër të fushës Jeta dhe puna, në bazë të vendimit të aprovuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës në vitin 2019.

Përmbajtja e tekstit përfshin temat e shtjelluara në bazë të librit të lëndës "Shkathtësi për jetë 3"::

1) Materialet dhe përpunimi i tyre;
2) Njohja nga rreziqet;
3) Karriera ime;
4) Planifikimi;
5) Mjedisi dhe shëndeti;
6) Mediet.

Libri i mësuesit "Shkathtësi për jetë 3" synon t'u vijë në ndihmë mësuesve, duke dhënë modele të ndryshme se si mund të realizohen Rezultatet e të Nxënit të Lëndës (RNL) gjatë procesit mësimor për temat e përcaktuara.
Libri i mësuesit ka këtë strukturë:

a) Programi i lëndës "Shkathtësi për jetë për klasën e tretë";
b) Plani vjetor;
c) Planet dymujore;
d) Planet ditore për çdo njësi mësimore;
e) Testet vlerësuese për tri periudha.

Me respekt,

Autorët

**PËRMBAJTJA**


Parathënie ........ 2

Programi i lëndës Shkathtësi për jetë për klasën e 3-të ........ 4

Hyrje ........ 4

Qëllimi ........ 4

Temat dhe rezultatet e të nxënit ........ 5

Udhëzime metodologjike ........ 8

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare ........ 8

Udhëzime për vlerësim ........ 9

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore ........ 10

PLANI VJETOR - 2020/2021 ........ 11

PLANI DYMUJOR shtator-tetor ........ 12

PLANI DYMUJOR nëntor-dhjetor ........ 27

PLANI DYMUJOR janar-shkurt-mars ........ 46

PLANI DYMUJOR prill-maj-qershor ........ 68

Testet vlerësuese periodike ........ 81

Testi vlerësues - Periudha e parë ........ 81

Testi vlerësues - Periudha e dytë ........ 83

Testi vlerësues - Periudha e tretë ........ 85

**Programi i lëndës "Shkathtësi për jetë për klasën e tretë"**

## Hyrje

Lënda " Shkathtësi për jetë" në klasën e tretë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive drejt përvetësimit të njohurive të reja, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për të ngritur vetëdijesiminidhe vetëbesiminipër ushtrimin e punës praktike, përdorimin e TIK-ut, bashkëpunimin lidhur me ekonominë familjare, me mjedisin jetësor dhe meeorientiminipër jetë dhe për punë.

Lënda "Shkathtësi për jetë" ndihmon që nxënësit të përgatiten për punë dhe për jetë në shekullin e 21-të, duke e kaluar theksin nga mësimdhënia e njohurive të nxënësve pasivë në atë të zhvillimit të kompetencave, shkathtësive dhe qëndrimeve përmes mësimnxënies aktive.

Në kuadër të lëndës "Shkathtësi për jetë" do të zhvillohen module, të cilat synojnë t'i'përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën 2, si: Punëdore, Zhvillimi personal, Shkathtësi për jetë, Këshillimi dhe Orientimi në karrierë, Ekonomia familjare, Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe Puna dhe edukimi për ndërmarrësi. Të gjitha këto koncepte zhvillohen në ndërlidhje të rezultateve të fushës dhe të lëndës për ta arritur qëllimin kryesor të fushës Jeta dhe Puna.

Kjo lëndë përfshin përpjekjet sistematike për të ndikuar në procesin e zhvillimit të nxënësve, të cilët përmes procesit të të mësuarit përdorin materiale të ndryshme, mjetet e punës të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive për jetë dhe për punë. Lënda ndikon te fëmijët në zhvillimin e mendimit kritik, zhvillimin e aftësive për të zgjidhur probleme, nxitjen e kreativitetit, aftësinë prezantuese, rritjen e vetëbesimit dhe punën ekipore.

## Qëllimi

Qëllimi i lëndës "Shkathtësi për jetë për klasën e tretë" është që nxënësi të njihet me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe neëpunë, të njihet me materialet e ndryshme dhe përdorimin e tyre, njohjen e rreziqeve, zhvillimin e karrierës, planifikimin e ekonomisë familjare, mjedisin dhe shëndetin, si dhe mediet.

Nëpërmjet lëndës "Shkathtësi për jetë" rritet niveli i njohurive dhe iishkathtësive për jetën e përditshme, duke përfshirë konceptet bazë të fushës Jeta dhe puna.
Përmes lëndës "Shkathtësi për jetë, për klasën e tretë", mësimi në shkollë bëhet më atraktiv dhe më i kënaqshëm përmes aktiviteteve të ndryshme praktike, në të cilat nxënësit nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në klasën e tretë është që nxënësit t'iiidentifikojnë interesimet e tyre për ndonjë veprimtari apo shkathtësi, siç janë: përpunimi i materialeve ricikluese, moderimi, krijimi i gazetës shkollore apo i asaj në klasë, qepja, prerja, matja, organizime të ndryshme (humanitare, argëtuese) etj.

Shkathtësitë më të rëndësishme jetësore, që nxënësi duhet t'i arrijë nëpërmjet lëndës "Shkathtësi për jetë", janë:
ë menduarit kreativ dhe kritik;

- Shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësitë e marrjes së vendimeve;

- Shkathtësitë e komunikimit;
- Ballafaqimi me emocionet dhe me stresin;
- Aftësitë për të prezantuar;
- Puna në grup;
- Shkathtësitë sipërmarrëse.

### Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e tretë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Jeta dhe puna, të shkallës së parë të kurrikulës (shk. 2) në Kurrikulën Bërthamë për arsimin fillor:

<table>
<tr><th>Koncepti</th><th colspan="2">RNF, TEMA dhe RNL</th></tr>
<tr><td rowspan="3">Zhvillimi i bazuar në aktivitete praktike manuale (Punëdore)</td><td colspan="2">RNF<br>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.<br>1.1. Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup.<br>1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.<br>2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe për punë<br>Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.</td></tr>
<tr><td>Tema</td><td>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</td></tr>
<tr><td>1. Materialet dhe përpunimi i tyre</td><td>Nxënësi:<br>-Përshkruan procesin e prodhimit të letrës dhe të kartonit.<br>-Klasifikon llojet e letrës dhe të kartonit.<br>-Identifikon vetitë e ndryshme të letrës dhe të kartonit.<br>-Modelon objekte nga letra dhe kartoni.<br>-Dallon materialet, si: leshi, pambuku dhe materialet sintetike si zëvendësim i materialeve natyrore.<br>-Përshkruan procesin e qethjes, larjes, pastrimit dhe krehjes së leshit.<br>-Përshkruan procesin e kultivimit, tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut.</td></tr>
<tr><td>Zhvillimi personal, shkathtësi për jetë</td><td colspan="2">RNF<br>3. Përdorimi i teknologjisë për jetë dhe për punën e përditshme<br>3.1. Përdor vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë.<br>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë<br>6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.</td></tr>
<tr><td></td><td>2. Njohja e rreziqeve</td><td>Nxënësi:<br>-Përshkruan burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet dhe instalimet e ndryshme elektrike.<br>-Zbaton rregullat e përdorimit të drejtë të pajisjeve</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | | elektrike: prizat, çelësat, poçat, përçuesit etj.<br>-Identifikon shkaqet potenciale për shpërthimin e zjarrit dhe merr masa për parandalimin e tij.<br>-Identifikon rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, ballkone, kulme, ashensorë, pastaj puse, puseta etj., si dhe masat preventive për mënjanimin e këtyre rreziqeve.<br>-Njihet me rreziqet që shkaktojnë valët e internetit, telefonit etj., dhe vetëdijesohet për përdorimin e drejtë të pajisjeve elektronike.<br>-Identifikon disa nga substancat kryesore kimike dhe mjetet shpërthyese që mund t'i hasë nxënësi në shtëpi, në shkollë, nënterren të hapur etj. |
| **Këshillimi dhe orientimi në karrierë** | **RNF**<br>**4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme**<br>4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.<br>4.2. Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.<br>**7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme**<br>7.1. Demonstron, përmes veprimeve të veta, nevojën për marrjen e përgjegjësive, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, në shkollë dhe nënkomunitet. | |
| | **3. Karriera ime** | Nxënësi:<br>-Prezanton para klasës përmes TIK-ut imazhe që ndërlidhen me punën dhe profesionet.<br><br>-Identifikon përmes objekteve/institucioneve llojet e vendeve të punës.<br><br>-Paraqet shkathtësi dhe dëshirën për profesionin e tij të ardhshëm.<br><br>-Krijon një projekt të vogël me materiale të ndryshme që lidhen me profesione të caktuara. |
| **Ekonomia familjare** | **RNF**<br>**1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet**<br>1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavaruara për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim..<br>**5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit**<br>5.1. Drejtpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative–buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërrmarrësit. | |
| | **4. Planifikimi** | Nxënësi:<br>-Kontribuon në ekonominë familjare.<br>-Organizon aktivitete argëtuese, humanitare, për |

| | | |
|---|---|---|
| | | ruajtjen e mjedisit etj.<br>-Planifikon dhe punon një produkt prej materialeve ricikluese. |
| **Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm** | **RNF**<br>**6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë**<br>6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe për siguri nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.<br>**9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit**<br>9.1. Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.<br>9.2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut. | |
| | **5. Mjedisi dhe shëndeti** | Nxënësi:<br>-Identifikon repartet, punishtet dhe pajisjet që prodhojnë zhurmë të lartë, si: ato për përpunimin e drurit, të materialeve plastike etj., që gjenden pranë mjedisit jetësor.<br><br>-Përpilon orarin e lojës apo të argëtimit në kohën kur nuk eepengon mjedisin jetësor.<br><br>-Përshkruan dëmet që shkaktohen në mjedis nga djegia e mbeturinave, tymtarët e fabrikave, lirimi i gazrave nga makinat etj.<br><br>-Prezanton situatat e ndryshme se si bëhet mbrojtja e mjedisit.<br><br>-Përshkruan prezencën e deponive, grumbullimin e mbeturinave dhe riciklimin e tyre. |
| **Puna dhe edukimi për ndërmarrësi** | **RNF**<br>**2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe për punë**<br>2.1. Demonstron gatishmëri dhe vetinicativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.<br>**4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme**<br>4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.<br>4.2. Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike. | |
| | **Mediet** | Nxënësi:<br>-Prezanton para klasës disa lloje mediesh, që shikon në shtëpi për moshën e tij.<br>-Moderon aktivitete brenda klasës para prindërve për festa të ndryshme.<br>-Organizon aktivitete të lira në kuadër të grupeve kulturore brenda klasës.<br>-Prezanton përmes TIK-ut aktivitetet e grupit të tij |

| | | |
|---|---|---|
| | | për një periudhë të caktuar kohore.<br>-Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe me imazhe interesante. |

## Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në lëndën Shkathtësi për jetë, për klasën e tretë, mund të përdoren metodat e ndryshme të punës, me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo lëndë, por edhe për shkak të specifikave që mbart me vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:
-Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, në grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
-Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
-Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale, e në veçanti përmes kompjuterit;
-Ushtrime-luajtje rolesh;
-Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe ii shkathtësive, puna interaktive;
-Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në të gjitha rastet, zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialit dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

## Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Në kuadër të lëndës Shkathtësi për jetë, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KK. Çështjet ndërkurrikulare, që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel dhe që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

-Edukimi për qytetari demokratike;;
-Edukimi për paqe;;
-Globalizimi dhe ndërvarësia;;
-Edukimi për medie;;
-Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Lënda Shkathtësi për jetë duhet të realizohet në atë mënyrë që t'u mundësojmë nxënësve përmirësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave kryesore të parapara në KK. Organizimi i mësimit duhet të përqendrohet në atë se çka duhet të dinë dhe çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit. Ajo pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, por edhe përmes qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet t'i reflektojnë.

Në kuadër të lëndës Shkathtësi për Jetë, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KK.

Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:
• Njohja e medies (përdorimi i medies për ta kuptuar botën përreth);
• Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë);
• Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
• Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit;
• Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë;
• Puna vullnetare.

## Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe mjaft të rëndësishme të mësimdhënies në shkollën bashkëkohore.
Nxënësit nxënë mjaft gjatë viteve të shkollimit. Sidoqoftë, jo gjithçka që ata nxënë mund të matet me anë të testeve, edhe për faktin se për nxënësit e nivelit fillor përdorimi i teknikave të ndryshme mundëson vlerësim sa më realist bazuar në karakteristikat e ndryshme të nxënësve.

Lënda Shkathtësi për jetë, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ku fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe të punës; konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe i qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje në vazhdimësi dhe në mënyrë aktive t'i zbatojnë në praktikë, në jetën e tyre të përditshme, njohuritë e mësuara.

Për shkak të specifikave që ka kjo lëndë, do të ishte e vlefshme që, përveç vlerësimit numerik, në masë të madhe të aplikohej vlerësimi përshkrues, pasi puna në grup, projektet, aftësitë psiko-motore, aftësia e të folurit etj., nuk mund të maten me anë të testeve. Për t’i matur dhe për t’i vlerësuar ato, përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për këtë lëndë dhe për këtë punë, e cila mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë në vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, të cilat përdoren për vlerësim. Ja disa prej tyre:

**Buletini i pjesëmarrjes,** përshkruhet si një teknikë vrojtimi që mund të përdoret për të vrojtuar, në grupe të vogla ose gjatë diskutimit. Buletini tregon se cili jep ndihmesë, sa shpesh bashkëpunon, sa të vlefshme janë ndihmesat etj.

**Lista e kontrollit,** është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, njohuri, për të cilat nxënësi do të vëzhgohet. Qëllimi kryesor i listës së kontrollit është të regjistrojë një vlerësim të vazhdueshëm për përparimin e nxënësit, duke dëshmuar se si i përmbush ai detyrat ose objektivat e llojeve të ndryshme. Krahas listës me elementet që do të vrojtohen, jepet edhe një shkallë vlerësuese.

**Dosja e nxënësit,** është një mjet që mund të përdoret për të treguar modele të punëve të nxënësve, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve. Dosja mund të përmbajë, për shembull: vizatime, një projekt, një krijim, plane etj.
Dosja ka vlera për këto arsye:
• Është një mjet që uajep informacion mësuesit, prindërve dhe nxënësve.

• Nxënësit i jep një pasqyrë tërësore të punës së tij.
• Duke e përgatitur vetë dosjen, nxënësi luan rol aktiv në procesin e mësimit dhe të vlerësimit.

**Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin me sukses të kompetencave në këtë lëndë, është e rëndësishme që të përdoren burime të ndryshme mësimore për t'i motivuar nxënësit dhe për të stimuluar progresin e tyre, në mënyrë që të përvetësojnë shprehi dhe shkathtësi të nevojshme për jetë dhe për punë. Meqenëse tekstet shkollore janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të nxënies, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet të kufizohet vetëm në tekstet shkollore, por edhe në burime të tjera, të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizim më të suksesshëm të lëndës, duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune. Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatura mësimore, p.sh., rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

Mësimdhënësit mund të përgatisin dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe për prodhimin e materialeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

**PLANI VJETOR - 2020/2021**

**Fusha e kurrikulës: Shkathtësi për jetë   Klasa : e tretë**

| Lëndët e fushës kurrikulare | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | | Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës |
|---|---|---|---|---|---|
| | PERIUDHA (I) | | PERIUDHA (II) | PERIUDHA (III) | |
| | shtator- tetor (10 orë ) | nëntor – dhjetor (9 orë ) | janar- shkurt - mars (10 orë ) | prill – maj – qershor (7 orë ) | |
| Lënda: Shkathtësi për jetë | Materialet dhe përpunimi i tyre (8 orë)<br><br>Njohja nga rreziqet (2 orë) | Njohja nga rreziqet (6 orë)<br><br>Karriera ime (3 orë) | Karriera ime (1 orë)<br><br>Planifikimi (5 orë)<br><br>Mjedisi dhe shëndeti (4 orë) | Mediet (7 orë) | I. Komunikues efektiv<br>I.3, I.5, I.7, I.8.<br>II. Mendimtar kreativ<br>II.1, II.3, II.4, II.7.<br>III. Nxënës i suksesshëm<br>III.1, III.2, III.3, III.4, III.5, III.6, III.7.<br>IV. Kontribues produktiv<br>IV.1,IV.2, IV.3, IV.4, IV.5, IV.6, IV.7<br>V. Individ i shëndoshë<br>V.1, V.3, V.4, V.5, V.6, V.7.<br>Qytetar i përgjegjshëm<br>VI.1, VI.2, VI.3, VI.4, VI.6, VI.7, VI,8 |

# PLANI DYMUJOR (shtator-tetor)

**Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna**
**Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë**
**Klasa: III**

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Materialet dhe përpunimi i tyre (8 orë)**<br><br>**Rreziqet (2 orë)** | • Përshkruan procesin e prodhimit të letrës dhe të kartonit.<br>• Klasifikon llojet e letrës dhe të kartonit.<br>• Identifikon vetitë e ndryshme të letrës dhe të kartonit.<br>• Modelon objekte nga letra dhe kartoni.<br>• Dallon materialet, si: leshi, pambuku dhe materialet sintetike si zëvendësim i materialeve natyrore. | • Prodhimi i letrës;<br>• Prodhimi i kartonit;<br>• Llojet e letrës dhe të kartonit;<br>• Vetitë e letrës dhe të kartonit;<br>• Punimi i modeleve nga letra dhe nga kartoni;<br>• Leshi, pambuku dhe materialet sintetike;<br>• Procesi i përpunimit të leshit;<br>• Rreziqet nga instalimet elektrike;<br>• Rreziku nga zjarri; | 10 orë | Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në kompetenca;<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar;<br><br>Gjithëpërfshirja, | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Lista e kontrollit;<br><br>Portofolio e nxënësit, | Njeriu dhe natyra;<br>Gjuhë shqipe;<br>Edukat fizike sporte dhe shëndeti;<br>çështjet ndërkurrikulare;<br>Arsimi per zhvillim të qëndrueshëm. | Tekstet shkollore;<br>Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve;<br>Librat e punës;<br>Broshura;<br>Atlasa;<br>Enciklopedi;<br>Interneti:<br>//<br>www..schoolme.education/scho ol/ . |

| NJËSIA MËSIMORE: Materialet dhe përpunimi i tyre<br><br>Prodhimi i letrës |
|---|

| Fusha kurrikulare:<br>**Jeta dhe puna** | Lënda:<br>**Shkathtësi për jetë** | Shkalla e kurrikulës:<br>**Shkalla 2** | Klasa:<br>**3** |
|---|---|---|---|

| **Njësia mësimore 1:1** | **RNSH:** I-1, 3,8, II01,3,4, III-1,2,4, V-8, VI-2,6.<br>**RNF:** 1:1, 2:1, 3:2, 4:1, 6:1. |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>Përshkruan mënyrën e prodhimit të letrës;;<br>Emërton lëndën e parë për prodhim;;<br>Dallon vetitë e letrës. | |

**Kriteri i suksesit:**
Përshkruani mënyrën e prodhimit të letrës. Emërtoni lëndën e parë për prodhim.Dalloni vetitë e letrës.
**Fjalë kyçe:** letër, material, celulozë, dru etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA**

**Pjesa hyrëse:** 5-10′ – Stuhi mendimesh

Parashtroji pyetjen nxënësve:

- Çfarë prodhohet nga druri?
- Përveç orendive, dyshemesë, dyerve, dritareve, a di ndokush të na tregojë se çfarë tjetër prodhohet nga druri?

**Pjesa kryesore: 20′- D.D.M.**

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Nga druri prodhohen: banka, karrige, orendi etj. | Nga çka prodhohet letra dhe si? | |

**Pjesa përfundimtare: 5-10′-Kllaster**




**Aktivitete shtesë:**

Ushtrojmë me vegla të punës, duke krijuar forma ose figura të ndryshme.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen sipas angazhimeve individuale.

**NJËSIA MËSIMORE: Materialet dhe përpunimi i tyre**

**Prodhimi i kartonit**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| | |
|---|---|
| **Njësia mësimore 1:2** | **RNSH:** I-1, 3,8, II-1,3,4, III-1,2,4, V-8, VI-2,6.<br>**RNF:** 1:1, 2:1, 3:2, 4:1, 6:1. |

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**

**Nxënësi/ja:**

Përshkruan mënyrën e prodhimit të kartonit;;
Krahason vetitë e letrës dhe tëëkartonit;
Modelon figura nga letra dhe nga kartoni.

**Kriteri i suksesit:**
Përshkruani mënyrën e prodhimi të kartonit.;Krahasoni vetitë e letrës dhe tëëkartonit.; Modeloni figura nga letra dhe nga kartoni.

**Fjalë kyçe:** karton, prodhim, letër, figura etj.

**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10’ - Parashikimi me terma paraprakë.
Mësuesi me një copë kartoni në dorë shpalos shtresat dhe copëton për të vërejtur se është letër e shtresuar dhe e vrazhdë.

**Pjesa kryesore:** 20’

Mësuesi/ja, pasi demonstron para nxënësve shtresat e kartonit dhe konkludon se ai është letër e vrazhdë, por e palosur në shtresa dhe e ngjitur me ngjitëse, u shpjegon nxënësve se fitohet në të njëjtën mënyrë si letra, vetëm se paloset i valëzuar disa herë dhe ngjitet me ngjitës.

Mësuesi/ja parashtron pyetjet:

- Ku keni parë këso pako kartoni?

- Për çfarë përdoret kartoni?

**Pjesa përfundimtare:** 5-10’- Bashkëbisedim

Bashkëbisedojmë me nxënësit per përdorimin e kartonit si dekorim.

**Aktivitete shtesë:**

Nxënësit krijojnë pako dekorative nga kartoni dhe ngjitësi.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen sipas bashkëpunimit në grupe.

**NJËSIA MËSIMORE: Llojet, vetitë e letrës dhe tëtkartonit**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| | |
|---|---|
| **Njësia mësimore 1:3** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,3,4, III-1,2,4, V-8, VI-2,6.<br>**RNF:** 1:1, 2:1, 3:2, 4:1, 6:1. |

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Shpjegon llojet dhe vetitë e kartonit me peshë, trashësi dhe ngjyra të ndryshme.
Rendit vetitë e letrës dhe të kartonit.
Modelon figura të ndryshme nga letra dhe nga kartoni.

**Kriteri i suksesit:**
Shpjegoni llojet dhe vetitë e kartonit me peshë, trashësi dhe ngjyra të ndryshme. Renditni vetitë e letrës dhe të kartonit.;Modeloni figura të ndryshme nga letra dhe nga kartoni.
**Fjalë kyçe:** letër, karton, veti, ngjyra, peshë etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10' – Demonstrim
Mësuesi/ja merr në një enë me ujë disa lloje të letrës dhe tëtkartonit për t'i'idemonstruar vetitë e tyre:
- Sipas trashësisë.
- Sipas ngjyrës.

**Pjesa kryesore:** 20' – Diagrami i VENIT




**Pjesa përfundimtare:** 5-10'-Punë praktike
Vizatojmë në letër qengjin sipas udhëzimeve në tekst.

**Aktivitetesshtesë:**
Të plotësojnë F.P., duke krijuar një byzylyk dore me anë të letrës dhe të kartonit.

**Vlerësimi:**
Vlerësimi bëhet sipas përshkrimit të vetive të letrës dhe të kartonit në demonstrimin në klasë.

| NJËSIA MËSIMORE: Leshi, pambuku dhe materialet sintetike |
|---|

| Fusha kurrikulare: **Jeta dhe puna** | Lënda: **Shkathtësi për jetë** | Shkalla e kurrikulës: **Shkalla 2** | Klasa: **3** |
|---|---|---|---|

| **Njësia mësimore 1:4** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2, V-8..<br>**RNF:** 1:1, 2:1, 3:2, 4:1. |
|---|---|

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Rendit procesin e përpunimit të leshit, pambukut dhe sintetikës;;
Klasifikon përpunimet e secilit material;;
Debaton për materialet e përpunuara.

**Kriteri i suksesit:**
Renditni procesin e përpunimit të leshit, pambukut dhe sintetikës. Klasifikoni përpunimet e secilit material. Debatoni për materialet e përpunuara.
**Fjalë kyçe:** material, lesh, pambuk etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10' – Stuhi mendimesh

- Si quhet kjo shtazë?
- Çfarë të mira marrim nga delja?
- Lëkura e mbushur me qime, çka mendoni, për çfarë përdoret?

**Pjesa kryesore:** 20'-



**Pjesa përfundimtare:** 5-10′-Lapsat në mes-
Nxënësit ndahen në grupe dhe diskutojnë rreth materialeve sipas kualitetit të të cilave ata preferojnë të vishen.

**Aktivitete shtesë:**
Nxënësit punojnë fjollat e borës në F.P.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen sipas përgjigjeve të dhëna në realizim të orës mësimore.

**NJËSIA MËSIMORE: Procesi i përpunimit të leshit**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| | |
|---|---|
| **Njësia mësimore 1:2** | **RNSH:** I-1,3, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 1:1, 2:1, 3:2, 4:1. |

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Kupton sa herë në vit bëhet qethja, në cilën stinë dhe arsyen pse në atë stinë;;
Dallon procesin e larjes, krehjes dhe tjerrjes;;
Modelon figura me lesh.

**Kriteri i suksesit:**
Kuptoni sa herë në vit bëhet qethja, në cilën stinë dhe arsyen pse në atë stinë. Dalloni procesin e larjes, krehjes dhe tjerrjes. Modeloni figura me lesh.
**Fjalë kyçe:** përpunim, lesh, larje, krehje etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10’
Demonstrojnë një copë leshi të palarë dhe njëkohësisht bashkëbisedojnë në bazë të pyetjeve të parashtruara:

- A ju duket e larë kjo copë leshi?
- A është e njëjtë si në xhemperin tuaj?

**Pjesa kryesore:** 20’- Tryeza e rrumbullakët
Nxënësit diskutojnë për larjen e leshit. Duhet cekur që ndyrësirat dhe gjaku më mirë pastrohen në fillim me ujë të ftohtë, pastaj vazhdon ecuria.

Krehja bëhet me dorë apo me makinë, tjerrja gjithashtu bëhet me makinë ose me dorë.

**Pjesa përfundimtare:** 5-10’- Teli i tharjes

**Aktivitete shtesë:**
Copëzat e letrës me emërtimet e përpunimit të leshit vendosen mbi bankë dhe nxënësit me përsëritje i ngjesin ato me radhë.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen gjatë punës në grupe.

**NJËSIA MËSIMORE: Kultivimi dhe përpunimi i pambukut**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| | |
|---|---|
| **Njësia mësimore 1:6** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 1:1, 2:1, 3:2. |

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Kuptojnë se pambuku është bimë, që duhet mbjellë dhe duhet kujdesurupër të, pasi vilet, tirret dhe endet.
Numëron ecurinë e prodhimit dhe të përpunimit.

Dallon leshin nga pambuku.

**Kriteri i suksesit:**
Kuptoni se pambuku është bimë që duhet mbjellë dhe duhet kujdesur, pasi vilet, tirretidhe endet. Numëroni ecurinë e prodhimit dhe të përpunimit. Dalloni leshin nga pambuku.
**Fjalë kyçe:** pambuk, bimë, mbjellje, vjele etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10’– Parashikime me anë të titullit.
Një foto të zmadhuar të pambukut. Çka është kjo në fotografinë e dhënë?
Diskutojmë me nxënësitise pambuku është bimë dhe zhvillohet procesi i mbjelljes gjer te endja.

**Pjesa kryesore:** 20’- Pema e mendimeve

**Pjesa përfundimtare:** 5-10′- Pesëvargëshi

_________ Pambuku _________
_________ ________ _________
____________________________

**Aktivitete sshtesë:**
Nxënësit udhëzohen tëapunojnë me pambuk dhe me karton në bazë të F.P.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen sipas plotësimit të pemës së mendimeve.

**NJËSIA MËSIMORE: Njohja me rreziqet**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| | |
|---|---|
| **Njësia mësimore 2:1** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 3:1, 6:1. |

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Njihen me rreziqet që mund t'i'hasin në jetën e përditshme.
Përshkruan burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet elektrike ose nga natyra të tjera.
Numëron rreziqet e mundshme dhe parandalimet.

**Kriteri i suksesit:**
Njihen me rreziqet që mund t'i'ihasin në jetën e përditshme. Përshkruan burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet elektrike ose nga natyra të tjera. Numëron rreziqet e mundshme dhe parandalimet.
**Fjalë kyçe:**rrrezik, pajisje elektrike, zjarr, kimikale etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10’-DDM

| **Di** | **Dua të di** | **Mësova** |
|---|---|---|
| Rreziqet janë: rryma elektrike, zjarri, ujërat e thellë. | Si t'i parandalojmë rreziqet? | |

**Pjesa kryesore:** 20'- Diagrami i VENIT




**Pjesa përfundimtare:** 5-10'-Karrigia e autorit

Vendoset karrigia te tabela dhe nxënësit dëgjojnë tregimet e autorit, që merr fjalën për të rrëfyer për ndonjë përjetim personal nga ndonjë rrezik që ka pasur vetë ose në familje.

**Aktivitete sshtesë:**
Të plotësohen emrat e rreziqeve në bazë të figurave të dhëna në F.P.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen sipas përgjigjeve të dhëna në DDM.

**NJËSIA MËSIMORE: Rreziqet nga instalimet dhe pajisjet elektrike**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| **Njësia mësimore 2:2** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 3:1, 6:1. |
|---|---|

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Numërojnë pajisjet elektrike të familjes;;
Tregojnë rreziqet e mundshme nga pajisjet elektrike;;
Shpjegojnë parandalimet e mundshme - izolatorët.

**Kriteri i suksesit:**
Numëroni pajisjet elektrike të familjes. Tregoni rreziqet e mundshme nga pajisjet elektrike. Shpjegoni parandalimet e mundshme – izolatorët.
**Fjalë kyçe:** pajisje elektrike, rreziqe, izolatorë, parandalim etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10'- Stuhi mendimesh



**Pjesa kryesore:** 20’- Citat - kkoment

| Rreziqet | Parandalimi |
|---|---|
| • Priza<br>• Tharësja<br>• Stufa<br>• Nxehësi i ujit | • Aparatet elektrike asnjëherë mos t’i prekim me duar të lagura.<br>• Mos të hedhim ujë në aparate elektrike |

**Pjesa përfundimtare:** 5-10’**-** Pesëvargëshi

Rryma elektrike

_________ _________

_________ _______ _________

_________________________________

**Aktivitete shtesë:**

Nxënësit plotësojnë mendimet e djaloshit në foton e dhënë në F.P.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen sipas plotësimit të pesëvargëshit dhe angazhimit gjatë orës mësimore.

**PLANI DYMUJOR ëntor-dhjetor**

**Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë Klasa: III**

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndëTt e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Njohja dhe rreziqet (6 orë)**<br><br>**Karriera ime 3 (orë)** | • Përshkruan burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet dhe instalimet e ndryshme elektrike.<br>• Zbaton rregullat e përdorimit të drejtë të pajisjeve elektrike.<br>• Indetifikon rrezikun nga lëvizjet e | • Parandalimi i rrezikut nga zjarri.;<br>• Rreziku nga lartësia, ashensori dhe puset.;<br>• Rreziku nga telefoni dhe valët e internetit.;<br>• Amari dhe | 9 orë | Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në kompetenca;;<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar;;<br><br>Gjithëpërfshiraja. | Buletini i pjesëmarrjes;;<br><br>Lista e kontrollit;;<br><br>Portofolio; i Nxënësit.. | Njeriu dhe natyra;;<br>Gjuhë shqipe;;<br>Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti;;<br>Çështjet ndërkurrikulare; ;<br>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.. | Tekstet shkollore;;<br>Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve;;<br>Librat e punës;;<br>Broshura;;<br>Atlasa; Enciklopedi<br>Interneti:// .schoolme. education/school/.. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | pakujdesshme në lartësi.<br>• Njihet me rreziqet që shkaktojnë valët e internetit.<br>• Identifikon disa nga substancat kryesore kimike.<br>• Dallon mjetet shpërthyese që mund të hasë nxënësi në shtëpi, në shkollë dhe nnë terren të hapur.<br>• Identifikon nëpërmjet objekteve të institucioneve llojet e vendeve të punës. | Fiona me lojëra interneti.;<br>• Rreziku nga substancat kimike.;<br>• Rreziku nga mjetet shpërthyese.;<br>• Rreziku nga tërmetet.<br>• Çfarë punojnë të rriturit?<br>• Çfarë bëjnë këta persona?<br>• Të bisedojmë për disa profesione. | | | | | |

| NJËSIA MËSIMORE: Rreziku nga zjarri |
|---|

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| **Njësia mësimore 2:3** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 3:1, 6:1. |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>Diskuton për rreziqet e mundshme nga zjarri në shtëpi, në shkollë dhe në natyrë.<br>Përkufizon sjelljet me aparate apo gjëra që shpiejnëëte zjarri i padëshiruar.<br>Numëron parandalimet e mundshme nga vetë ai. | |

**Kriteri i suksesit:**
Diskutoni rreziqet e mundshme nga zjarri në shtëpi, nënshkollë dhe në natyrë. Përkufizoni sjelljet me aparate apo gjëra që shpiejnëjte zjarri i padëshiruar. Numëroni parandalimet e mundshme nga vetë ai.
**Fjalë kyçe:** zjarr, rrezik, parandalim, natyrë, shkollë etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10' – Stuhi mendimesh



**Pjesa kryesore:** 20’




**Pjesa përfundimtare:** 5-10’
Nxënësit e plotësojnë robotin e dhënë në F.P.

**Aktivitete sshtesë:**
Nxënësit numërojnë rreziqet dhe diskutojnë për parandalimet e mundshme.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen sipas plotësimit të F.P.

**NJËSIA MËSIMORE: Rreziku nga lartësia, ashensori dhe puset**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
| --- | --- | --- | --- |
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| | |
| --- | --- |
| **Njësia mësimore 2:4** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 3:1, 6:1. |

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Indentifikon rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, si::ballkone, kulme, ashensorë dhe puse.

Interpreton rreziqet e mundshme.
Zbaton në jetën e përditshme kujdesin ndaj vetes.

**Kriteri i suksesit:**
Indentifikoni rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, si:: ballkone, kulme, ashensorë dhe puse. Interpretoni rreziqet e mundshme. Zbatoni në jetën e përditshme kujdesin ndaj vetes.
**Fjalë kyçe:** rrezik, pakujdesi, lartësi, thellësi etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10' – Del rrotull/ fol rrotull

Nxënësit dalin një nga një për të numëruar raste të ndryshme të rrezikut nga lartësitë, ashensorët dhe puset.



**Pjesa kryesore:** 20'

| Rrezik | | Parandalimi i rrezikut |
|---|---|---|
| • Lartësia<br>• Ashensori<br>• Pusetat | → | |

**Pjesa përfundimtare:** 5-10’
Nxënësit i ilexojnë me kujdes udhëzimet dhe parandalimet dhe komentojnë në lidhje me to.

**Aktivitete shtesë:**
Nxënësit plotësojnë në bazë të imagjinatës kornizën e dhënë në F.P.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen sipas aktivitetit të treguar në orën mësimore.

**NJËSIA MËSIMORE: Rreziku nga telefoni dhe valët e internetit**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| Njësia mësimore 2:5 | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 3:1, 6:1. |
|---|---|

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Njihet me rreziqet që shkaktojnë valët e internetit.
Vetëdijesohet për përdorimin e drejtë të pajisjeve elektrike.
Praktikon përdorimin sa më të shkurtërrtë pajisjeve elektrike.

Pambuku

**Kriteri i suksesit:**
Njihuni me rreziqet që shkaktojnë valët e internetit.Vetëdijesohuni për përdorimin e drejtë të pajisjeve elektrike. Praktikoni përdorimin sa më të shkurtërrtë pajisjeve elektrike.
**Fjalë kyçe:** internet, pajisje elektrike, rrezik etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10’ – Parashikimi me anë të titullit

Diskutojmë me nxënësit lirshëm rreth videolojërave, filmave, emisioneve të preferuara dhe kohës së përdorimit të telefonit.



**Pjesa kryesore:** 20’- Diagrami i VENIT




**Pjesa përfundimtare:** 5-10’- Punë në grupe - Ruaje fjalën e fundit për mua.

Pasi lexojnë në tekst dobitë dhe dëmet nga rrezet elektronike, vazhdojnë me diskutimin për dëmet kryesisht me shpresë që do të ndikojmë pozitivitisht tek ata.

**Aktivitete shtesë:**
Lexojmë tekstin e parashtruar në L.B. Amari dhe Fiona me lojëra interneti, në mënyrë që të nxjerrim mesazhin negativ prej valëve të internetit.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen në mënyrë formative.

**NJËSIA MËSIMORE: Rreziku nga substancat kimike**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| **Njësia mësimore 2:6** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 3:1, 6:1. |
|---|---|

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**

**Nxënësi/ja:**

Numërojnë substancat kimike, të cilat i shohin në jetën e përditshme.

Dallojnë cilat substanca janë të dëmshme për shëndetin.

Shpjegojnë kujdesin ndaj atyre detergjentëve që përmbajnë substanca kimike.

**Kriteri i suksesit:**

Numëroni substancat kimike, të cilat i shihni në jetën e përditshme.

Dalloni cilat substanca janë të dëmshme për shëndetin. Shpjegoni kujdesin ndaj atyre detergjentëve, që përmbajnë substanca kimike

**Fjalë kyçe:** substancë kimike, detergjent, rrezik etj.

**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10’ – Bashkëbisedim

**Parashtrojmë pyetjet nxënësve: çfarë detergjentë shihni në shtëpinë tuaj? A i përdorni ju personalisht?**
**A dini çfarë janë detergjentët BIO?**



**Pjesa kryesore:** 20’- DDM

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Detergjentët kanë substanca kimike të rrezikshme. | Çfarë janë detergjentët bio? | |

**Pjesa përfundimtare:** 5-10’

Plotësojmë faqen në F.P. - Rreziku nga substancat kimike.

**Aktivitete shtesë:**
Lexojmë për detergjentët e natyrës bio, të prodhuar me bazë bimore, të përgatitur nga mësuesi/ja.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen sipas angazhimit dhe përgjigjeve të dhëna në orën mësimore.

| NJËSIA MËSIMORE: Rreziku nga mjetet shpërthyese |
|---|

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| **Njësia mësimore 2:7** | **RNSH:** I-1,3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 3:1, 6:1. |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>Mësojnë cilat janë mjetet shpërthyese;;<br>Kuptojnë se mjetet shpërthyese janë shumë të dëmshme;;<br>Dallojnë llojet e rrezikut nga mjetet shpërthyese. | |

**Kriteri i suksesit:**
Mësoni cilat janë mjetet shpërthyese. Kuptoni se mjetet shpërthyese janë shumë të dëmshme. Dalloni llojet e rrezikut nga mjetet shpërthyese.
**Fjalë kyçe:** mjet shpërthyes, rrezik, fishekzjarre etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë amtare, Matematikë, Artet figurative, Shoqëria dhe mjedisi etj.

**Pjesa hyrëse:** 5-10' – Bashkëbisedim

**Parashtrojmë pyetjet nxënësve:**

- **Si e festoni festën e Vitit të Ri në familjet tuaja?**
- **A mendoni se festa bëhet më e bukur me fishekzjarre?**



**Pjesa kryesore:** 20’-




**Pjesa përfundimtare:** 5-10’-

| Çfarë lexova? | Çfarë kuptova? |
|---|---|
| | |

**Aktivitete shtesë:**
Plotësojmë F.P., duke plotësuar tabelën me mjete piroteknike dhe fjalëkryqin.

**Vlerësimi:**
Nxënësit vlerësohen sipas përgjigjeve të dhëna në orën mësimore.

| NJËSIA MËSIMORE: Rreziku nga tërmetet |
|---|

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Jeta dhe puna** | **Shkathtësi për jetë** | **Shkalla 2** | **3** |

| **Njësia mësimore 2:8** | **RNSH:** I-3,8, II-1,4, III-1,2.<br>**RNF:** 3:1, 6:1. |
|---|---|

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
**Nxënësi/ja:**
Njoftohen me dukurinë e tërmeteve.
Dinë se si duhet të veprojnë në raste tërmeti.
Mësojnë se si të mbrohen nga tërmeti.

**Kriteri i suksesit:**
Njoftohuni me dukurinë e tërmeteve. Dini se si duhet të veproni në raste tërmeti. Mësoni se si të mbroheni nga tërmeti.
**Fjalë kyçe:** ttërmet, lëkundje, mbrojtje, lëndime të mundshme etj.
**Burimet:** Libri bazë, Fletore pune, interneti dhe fotografi të ndryshme.
